



**Bordi  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**VENDIM**

**Nr. 189, Datë 23.11.2017**

**MBI**

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR  
SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TEK KLIENTËT QË  
FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19 gërma "b"; të ligjit nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*"; neni 6 i VKM nr. 244 dt. 30.03.2016, "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*", nenit 26 të "*Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE*", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016"; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, mbi miratimin e "draft – Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal",

**Konstatoi se:**

- Me Vendimin Nr. 182 dt. 23.11.2016, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal.
- Vendimi u dërgua për publikim në shtypin e shkruar nëpërmjet shkresës nr. 26/44 prot, datë 09.12.2016 të ERE, për të marrë opinionin e palëve të interesit.
- ERE ka njoftuar të gjitha palët e interesuara (OSHEE sh.a; MEI; Autoriteti i Konkurrencës; Avokati i Popullit; Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit Shqiptar; Shoqata e Konsumatorit Shqiptar; Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë; Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfindustria)
- U paraqitën komente nga Electricity Trading Origination Manager for Albania and Kosovo.
- ERE organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të ERE dhe OSHEE sh.a. gjatë se cilës nuk u konstatuan të meta në draft.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal.” (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit AHMETI**

[https://ere.gov.al/doc/Metodologjia\\_FSHU-1.pdf](https://ere.gov.al/doc/Metodologjia_FSHU-1.pdf)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**Votimi i Bordit të ERE, për**

**VENDIMIN**

**Nr. 189, Datë 23.11.2017**

**MBI**

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR  
SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TEK KLIENTËT QË  
FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL.**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____